



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .2021

VENDIM
Nr. 536, Datë 17.11.2021

PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË,
NGA RADHËT E GJYQTARËVE, PËR NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË
DREJTËS CIVILE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1 të nenit 136, në pikën 1 të nenit 147 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3 të nenit 8, në shkronjën “a” të pikës 1 dhe në pikën 5 të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 61, në shkronjën “ç” të nenit 86 dhe në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

II. Afati i kandidimit

3. Afati i kandidimit është deri më datë 17.12.2021.

III. Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit

4. Në procedurën e ngritjes në detyrë sipas këtij vendimi mund të konkurrojë çdo gjyqtar që është në një pozicion në sistemin gjyqësor ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të emërimit në Gjykatën e Lartë.
5. Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen në pikën 3 të nenit 8, në pikën 5 të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:
 - a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

- b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar;
 - c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :
- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionet e lira të shpallura;
 - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
 - c) Fotokopje të kartës së identitetit;
 - ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Dokumentacioni sipas pikës 6, të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

IV. Procedura e kandidimit

8. Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, kandidatët i nënshtrohen procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të kandidimit sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar.
9. Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:
- a) sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimit të tij nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, për kandidatin në një pozicion në sistemin gjyqësor;
ose
 - b) sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimit të tij nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, për kandidatin në një pozicion të komanduar, i cili nuk ka vlerësim etik dhe profesional nga institucioni i sistemit të drejtësisë ku është i komanduar.

10. Për kandidatët e kualifikuar me vendim përfundimtar sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, zbatohet procedura e përzgjedhjes për emërim sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

VETËDEKLARIM

PËR MASA DISIPLINORE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk kam masë disiplinore në fuqi.

Lëshuar më _____.____.2021

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)
(Nënshkrimi)

VETËDEKLARIM

PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk do të ndodhem në situatën papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lëshuar më _____.____.2021

DEKLARUESI

(*Emri, atësia, mbiemri*)
(*Nënshkrimi*)